



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

ADRIAPOL – Smart and Creative Development

dhe

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare (DHBDSH) dhe Instituti ADRIAPOL – Smart and Creative Development, në vijim referuar si “Palët”

ADRIAPOL – Smart and Creative Development dhe Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare, përmes kësaj Marrëveshjeje, shprehin interesin e përbashkët për bashkëpunim, me qëllim optimizimin e veprimtarive në fushën e zhvillimit ekonomik, nevojës për të lidhur së bashku shkëmbimin e informacionit me mundësinë e partneritetit për krijimin e mbështetjen e programeve zhvillimore të përbashkëta.

Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim të jetë një deklaratë mirëkuptimi dhe bashkëpunimi i ndërsjellë dhe nuk është një kontratë me detyrime ligjore për secilën palë.

Instituti ADRIAPOL – Smart and Creative Development është një organizatë jo-fitimprurëse e themeluar në Janar 2014. Qëllimi kryesor i Institutit është krijimi i një qyteti të gjallë dhe tërheqës ku kreativitetit dhe inovacioni janë motoja për çdo ditë të jetës. Lidhja mes krijimtarisë, kulturës, ekonomisë dhe teknologjisë, e cila shprehet në aftësinë për të krijuar dhe për të qarkulluar kapitalin intelektual, ka gjithashtu potencial për të gjeneruar të ardhura e punësim, ndërsa në të njëjtën kohë, dhe njëkohësisht promovon përfshirjen sociale, diversitetin, zhvillimin kulturor dhe njerëzor. Misioni i Institutit është angazhimi në hulumtime, projekte arsimore dhe konsulencë dhe iniciativa të ndryshme për zhvillimin e një ekonomie të zgjuar dhe kreative.

Dhoma e Biznesit të Diasporës me vendim nr 6378, në datë 12 Nëntor 2019, pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, është e para strukturë e këtij lloji në shërbim të bizneseve të Diasporës. Si një organizatë e pavarur, jo-fitimprurëse, mbështet dhe nxit bizneset e të gjitha formave për të maksimizuar potencialin e tyre në Shqipëri. Dhoma e Biznesit të Diasporës është një mundësi reale për mbështetjen e investitorëve të Diasporës, që dëshirojnë të krijojnë apo të zgjerojnë biznese të tyre në atdhe.

Nder qëllimet kryesore të Dhomes së Biznesit të Diasporës Shqiptare, përfshihen a) nxitja dhe inkurajimi i sipërmarrjeve nga bizneset shqiptare të Diasporës në Shqipëri, për të krijuar vende të reja pune dhe për të rritur zhvillimin ekonomik; b) Ngritja e platformave të shkëmbimit të informacionit e të përvojës si dhe të ofertave tregtare ndërmjet sipërmarrjeve të Diasporës dhe bashkëpunëtorëve të tyre, në funksion të forcimit të prezencës ekonomike në Shqipëri dhe

prurjes së investimeve të reja; c) Advokimi për përmirësimin e politikave në kuadër të lehtësimit të tregtisë dhe investimeve të Diasporës në Shqipëri dhe ndikimi për lehtësimin e tregtisë;

Nisur nga interesi i të dy organizmave për krijimin e bashkëpunimit me qëllim arritjen e objektivave të përbashkëta, palët bien dakort me këto marrëveshje për qëllimet e poshtë permenduara:

PALËT NDAJNË QËLLIMET E MËPOSHTME:

1. Për optimizimin e mundësive për të çuar përpara zhvillimin ekonomik për njerëzit dhe komunitetet në vend, në lidhje me zhvillimin e programeve/projekteve në masën e duhur, brenda mundësive, kompetencave dhe mandateve përkatëse të Palëve.
2. Për mbështetje të burimeve të përgjegjshme për zhvillimin dhe riaktivizimin e kapitaleve njerëzore, përmes bashkëpunimit dhe angazhimit të përbashkët reciprok;
3. Organizimin e eventeve të përbashkëta, me qëllim promovimin dhe zhvillimin ekonomik të sektorëve të veçantë të ekonomisë shqiptare.

KOMUNIKIMI

- Palët do të bashkëpunojnë në zhvillimin e projekteve, në lidhje me programet jashtë dhe brenda vendit. Për nga rëndësia, secila palë do të bëjë publikimin/brandimin e emrit dhe imazhit, e realizuar në përputhje me përkatësitë ligjore dhe kërkesat procedurale.
- Palët do të respektojnë politikën e konfidencialitetit të njëri-tjetrit, me mirëkuptim reciprok, në rastet kur synojnë të publikojnë aleancën/parteneritetin dhe objektivat e tyre pa zbuluar ndonjë informacion konfidencial të palës tjetër.
- Palët duhet të organizojnë takime periodike, të paktën 2 (dy) herë në vit.
Personat përgjegjës për komunikim:

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare: Personi i kontaktit do të jetë: Znj. Faola Hodaj, Specialiste Projektsh pranë Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare.

ADRIAPOL: Personi i kontaktit do të jetë: Znj. Xhijola Abdihoxha, koordinatore e institutit.

KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga përfaqësuesit e të dyja palëve dhe mbetet në fuqi për 4 vjet nga data e firmosjes.

2. Me përfundimin e afatit, nëse asnjëra nga palët nuk shpreh vullnetin për t'i dhënë fund, kjo marrëveshje rinovohet për një afat tjetër 4-vjeçar.

I. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve firmëtare, të shprehur në një dokument të shkruar.
2. Mosrespektimi i kësaj marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej partnerëve, çon detyrimisht në prishjen e saj. Vullneti për mbarimin e marrëveshjes para afatit, komunikohet me shkrim nga partneri, duke argumentuar arsyet e këtij veprimi.
3. Kjo marrëveshje përmban 4 (katër) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje origjinale me të njejtën vlerë.

Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord sot në datë _____.2020.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

DREJTORI EKZEKUTIV
